

Titulli/Grada: Prof. Dr.
Emër Mbiemër: Kledi Xhaxhiu

I punësuar si personel akademik me kohë të plotë pranë Departamentit të Kimisë, të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, të Universitetit të Tiranës.

Ka një përvojë pune 17 vjeçare si pedagog dhe studiues.

Pas diplomimit në 2002 si Kimist Ushqimor pranë FShN, UT, në vitin 2005 ka kryer doktoraturën pranë Universitetit të Siegen-it, Gjermani dhe në vitin 2014 ka kryer postdoktoraturën pranë Universitetit Masaryk, Brno, Republika Çeke. Studimet pasuniversitare, doktorale dhe postdoktorale lidhen me sintezën, karakterizimin strukturor të përbërjeve inorganike të reja, kompoziteve polimer percjellës – përbërje inorganike dhe studimin e vetive fizike të tyre, termoelektrike, fotoelektrike, gas-sensitive, etj.

Ka mbrojtur titullin akademik “*Profesor*” në vitin 2016.

Fushat e mësimdhënies dhe ekspertizës kërkimore përfshijnë: Kiminë Fizike, Kiminë Koloidale dhe të Dukurive Sipërfaqësore, Kristalografinë dhe Spektroskopinë Molekulare.

Ka marrë pjesë në disa projekte kombëtare/ndërkombëtare: UNDP, NanoAlb ignite projects 2022, Cost Action CA19118.

Ka shërbyer si Zëvendës Ministër i Mjedisit në periudhën: Mars 2016 – Shtator 2017.

Ka botuar 64 artikuj shkencorë në revista kombëtare dhe ndërkombëtare, nga të cilët 32 të indeksuar në *Journal Citation Index (Scopus)*; dhe një Monografi në gjuhë të huaj.

Aktualisht, është profesor me kohë të plotë pranë Departamentit të Kimisë FShN, UT dhe njëkohësisht edhe bashkëkoordinator i Qendrës Kërkimore të Nanoteknologjisë (NanoAlb), pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.